



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 215/ prot

Elbasan më 28/03/ 2024

Lënda : Dërgim Specifikime teknike për mallin : " *Blerje mjete* " .

DREJTORISE PROKURIMEVE PUBLIKE

BASHKIA ELBASAN

Agjencinë e Shërbimeve Publike Elbasan po ju dërgon specifikimet teknike për mallin :
" *Blerje mjete* " .

SPECIFIKIMET TEKNIKE KAMIONCINA

- Kamioncina duhet të jetë me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për punë.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha pajisjet dhe aparaturat duhet të jenë funksionale dhe konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.
- Gabina duhet të jetë konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes (Kondicioner) Mjeti duhet të jete minimumi 4+1 (kabina të jete me 4 dyer)
- Kamioncina duhet të jetë e tipit veteshkarkues me karroceri metalike dhe me shasi të artikulluar
- Mjeti duhet të kete me dopio gome ne aksin e pasem.
- Mjeti duhet të kete nr e gomave nr.225/75 R16C,Gomat të jene te reja.
- Mjeti të jetë jo më i vjetër se viti 2016.
- Mjeti të ketë jo më shumë se 100 000 km dhe të jete me liber sherbimesh.
- Pesha e lejuar e mjetit me ngarkese duhet të jete jo me pak se 7000 kg
- Motorri të jetë me naftë me ftohje me lëng me fuqi jo më të vogël se 115 kv ose (156 hp)
- Vellimi i motorit të jete jo me i vogel 2900 cm 3
- Motorri të jetë në gjendje të mirë dhe të mos ketë rrjedhje vaji.
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Mjeti duhet të jetë e pajisur me manualet e operimit dhe servisimit
- Gjendje e përgjithshme optimale pasqyruar me foto të mjetit,të ketë paraqitje të jashtme të rregullt
- Mjeti duhet të jete i pajisur me manualet e përdorimit dhe servisimit
- Mjeti duhet të realizojë operimin kazanit (karrocerise):Te shkarkoje majtas-djathtas dhe mbrapa.
- Kapaciteti mbajtes (vellimi) ne m3 duhet të jetë jo me i vegël se 2.5 m3 (meter kub).

Garancia dhe shërbimi i pas shitjes

- Mjeti duhet të jetë i mbuluar me një garanci teknike dhe shërbimi , një vit nga dita e marrjes ne dorezim.
- Mjeti duhet te jete me dokumentacion te rregullt gati per targa nese nuk eshte me targa Shqiptare.
- Ofertuesi duhet të konfirmojë një servis i cili është operues në territorin e Shqipërisë duke dhënë adresën ose adresat ku mund të kryhen shërbimet e pas shitjes. Ky servis te pergjigjet me karrotrec ne rast te nje difekti si dhe te jetë përgjegjës për mbulimin e te gjitha shërbimeve gjatë periudhës së garancisë (në vendodhjen e mjetit) si dhe të ketë mundësinë e sigurimit të shërbimeve apo pjesëve të ndërrimit edhe pas përfundimit të periudhës së garancisë.
- Periudha e lëvrimit maksimum 1 (një) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- Çmimi i Kamioncines përfshin transportin deri në objekt.

SPECIFIKIMET TEKNIKE FADROMA

- Fadroma duhet të jetë plotësisht e montuar me të gjitha pajisjet standarte normale, dhe e gatshme për të filluar punë të menjëhershme.
- Fadroma duhet te kete aksesore shtese te tille si:kove me gjeresi minimumi 70 cm pa dhembe per pastrimin e kanaleve.Kove me gjeresi 30 cm per kollonen e pasme per hapjen e kanaleve te ngushta.
- Karakteristikat e sigurisë të sistemit të frenimit, drejtimit, ecjes, ndriçimit, dhe të gjitha paisjet dhe aparaturat duhet të jenë konform rregullave dhe standardeve të Bashkimit Europian.
- Fadroma duhet të jetë me shasi të artikuluar, hidraulik, me goma.
- Kollona e pasme te jete me rreshqitje nga njera ane ne tjetren
- Mjeti të jetë i ri.
- Pesha e mjetit duhet të jetë minimumi 8300 kg dhe jo me shume se 11000 kg
- Gjatesia e mjetit te jete jo me e vogel 5.7 m
- Gjeresia jo e me vogel se 235 cm
- Motorri të jetë me naftë me ftohje me ujë
- Motorri (vellimi) te jete jo me i madh se 4.4 L dhe jo me te vogel se 3.6 L
- Motorri te jete me fuqi jo më të vogël se 68.5 kw (kilovat) (91 hp)
- Motorri të jetë në gjendje të mirë dhe të mos ketë rrjedhje vaji.
- Pjesët hidraulike të jenë pa rrjedhje
- Gabina duhet të jetë konform rregullave të Bashkimit Europian, me sistem të ngrohjes dhe ftohjes etj
- Gomat aksi i pare t
- e jene 12.5/80-18,Gomat e aksit te pasem te jene me nr.16.9-28
- Kollona e pasme të jetë e operueshme në 180 gradë nga njera ane ne tjetren.
- Fadroma duhet të jetë e pajisur me manualet e operimit dhe servisimit
- Gjendje e përgjithshme optimale pasqyruar me foto të mjetit,të ketë paraqitje të jashtme të rregullt

- Fadroma duhet të realizojë operimin e njëkohshëm të kovës, kthimin majtas-djathtas të platformës së sipërme dhe mekanizmit të lëvizjes.
- Struktura e kollones se pasme te jete e levishme nga njera ane ne tjetren
- Fadroma duhet të jetë e pajisur me një kovë për pastrimin e rrugëve me kapacitet jo me te vogel se 1.03 m3 (meter kub)
- *Garancia dhe shërbimi i pas shitjes*
- Fadroma duhet të jetë e mbuluar me një garanci teknike 1000 ore pune nga dita e marrjes ne dorezim te mjetit.
- Ofertuesi me shpenzimet e tij duhet të trajtojë në një periudhë prej 2 ditësh drejtuesin e mjetit për përdorimin e fadromës dhe shërbimet e përditshme.
- Periudha e lëvrimit maksimum 1 (një) muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.
- Çmimi i fadromës përfshin dhe transportin deri në objekt
- Mjeti duhet te jete .i pajisur me dokumentacionin e duhur gati per targa, te mos kete detyrime te pa paguara
- Mjeti te jete i cdoganuar nese seshte i pajisur me dokumenta shqiptare.